

VENDIM
Nr. 535, datë 30.12.2021

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KOMISIONIT KOMBËTAR
RREGULLATOR NR. 272, datë 9.7.2021, “PËR LICENCIMIN E SHA UJËSJELLËS-
KANALIZIME KRUJË”**

Në mbështetje të neneve 13, 14, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (ligji nr. 8102); të VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë” (VKM-ja nr. 958), si dhe të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (Rregullore e licencimit),

KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR,

në mbledhjen e datës 30.12.2021, pasi shqyrtoi çështjen me objekt: “Mbi miratimin e vendimit ‘Për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar nr. 272, datë 9.7.2021, ‘Për licencimin e sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Krujë’”,

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Krujë (UK Krujë), me shkresën nr. 1095 prot., datë 2.12.2021, me lëndë “Shkresë përcjellëse”, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU-ja) kërkesën për rinovim të licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesin ligjor, të shoqëruar me dokumentacionin sipas përcaktimeve të parashikuara në VKM-në nr. 958 dhe Rregullores së licencimit.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës së UK Krujë për rinovim licence për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe Rregulloren e licencimit.

3. KKRR-ja ka licencuar shoqërinë UK Krujë me vendimin nr. 272, datë 9.7.2021, “Për licencimin e sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Krujë”, me një afat 4-vjeçar, ku shoqëria autorizohet të ofrojë shërbimin e grumbullimit dhe shpërndarjes së ujit për konsum publik, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura.

4. Drejtuesi ligjor i shoqërisë UK Krujë sh.a., z. Edi Salaj, ka përfunduar studimet e larta në Inxhinieri Miniera, në vitin 1999.

5. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për ndryshimin e licencës, për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor, ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Krujë sh.a. të kërkesave të ligjit nr. 8102, të VKM-së nr. 958 dhe Rregullores së licencimit, në mënyrë të veçantë sa i takon garantimit që i licencuari të veprojë në përputhje me kushtet e licencës së tij dhe të mbrojë interesat e konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i UK Krujë është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Në pikën 1, të vendimit të KKRR-së nr. 272, datë 9.7.2021, “Për licencimin e sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Krujë”, bëhen këto ndryshime:

“Drejtues ligjor – z. Edi Salaj”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani